

3. Gazeta shumëgjuhësore muri ose nxënësve/eve

prej klasës së 3/4

Format e ndryshme të gazetave të nxënësve/eve (përfshirë gazetat e murit dhe si mënyrë e re edhe format elektronike) janë tashmë të dashura që një kohë të gjatë. Ato lënë shumë mirë të zgjerohen në shumëgjuhësi (ashtu si mjaft gazeta të qytetit që kanë rubrika në gjuhët e mëdha të emigrantëve).

Varianti 1: Për temat e gazetës do të integrohen edhe kontributet nga gjuhët e tjera përpos gjuhës shkollorë. Këtu do të duhet që së paku teksti të përmblidhet në gjuhën shkollorë, në mënyrë që të gjithë të kenë diçka nga kjo.

Varianti 2: Do të krijohen rubrika speciale për lajme në gjuhë të ndryshme (p.sh. në lidhje me ngjarjet në vendet e prejardhjes). Edhe këtu është shumë e dëshirueshme një përbledhje e shkurtër në gjuhën shkollorë.

4. Kontributet për javët e projektit ose ekspozita si «Kulturat tona», «Prej nga vijmë ne», «Vende të mrekulluese për pushime», «Gjuhët tona» etj.

nga klasa e 4

Nxitja për të bërë një javë projekti ose një projekt me shumë klasa (ose mbredha klasës), i cili i shfrytëzon resurset shumëkulturore dhe shumëgjuhësore të bashkësisë së nxënësve do të duhet të ketë gjithsesi terren të begatshëm në shumë shkolla.

Rreth mundësive të ndryshme për bashkëpunim me mësimin në gjuhën e prejardhjes, illogaritet këtu edhe përkrahja tek përgatitja e referateve ose tek modelimi i pllakateve, fletëpalosjeve ose të reklamave turistike përvende të ndryshme.

Krahaso këtu edhe 10.1 dhe 12.

5. Përbledhje shumëgjuhësore e recetave

prej klasës së 2/3

Në bashkëpunim me mësimin e rregullt ose të amvisnisë ofrohet kjo ide përtë krijuar një përbledhje të recetave nga traditat në gjuhët e ndryshme të prejardhjes. Kjo mund të ndodhë shumë mirë edhe në dy – gjegjësisht në shumëgjuhësi, ku recetat në gjuhën e parë do të përpunohen në bashkëpunim me mësimin në gjuhën e prejardhjes (ose aty ku kjo mungon, me prindërit). E vetëkuptueshme që të gjitha recetat do të përkthehen në gjuhën shkollorë. Një situatë e përbashkët përtë zier, eventualisht në kuadër të një festë me prindërit ose të një festë të shkollës, e përfundon këtë projekt, i cili do të ishte i përshtatshëm edhe në kuadër të një jave projekti multikulturor.